



Raport i Transparencës 2020

Informacion per vitin fiskal 01/01/2020-31/12/2020

Armand Avdoli (person fizik)

Përmbajtja

Hyrje	3
Struktura ligjore	4
Politikat e kontrollit të cilësisë	5
Sherbimet qe Ofrojme	6
Cilësia e Auditimit	7
Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve të Konsulencës të Raportimit Financiar dhe Taksave	7
Cilësia e Shërbimeve të Konsulencës dhe te tjera	7
Informacione financiare	8
Njësi ekonomike me interes publik (NIP)	9
Njësi ekonomike me interes publik (NIP)	10

Hyrje

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin e transparencës të audituesit ligjor Armand Avdolli (person fizik) për vitin 2020.

Armand Avdolli është person fizik me qendër në Tiranë, i përkushtuar ndaj profesionalizmit dhe efijencës në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe konsulencës.

Qasja jonë është përputhshmëria e cilësisë së shërbimeve me ambiciet e klientëve tanë, sado të mëdhej apo të vegjël që ata janë, për të punuar së bashku në partneritet dhe për të kërkuar së bashku zgjidhjet e duhura duke i mbeshtetur ata që te behen te suksesshem. Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që këto kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme. Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me stafin tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për më shume se trembedhjete vite, ne ofrojmë shërbime drejt një numri të madh klientësh brënda vendit, duke bashkuar praktikat kombetare dhe ndërkombëtare me njohuritë dhe eksperiencën tonë.

I themeluar në Elbasan në mars të vitit 2006, Armand Avdolli është një entitet privat i pavarur dhe dinamik dhe së fundmi ka punuar në auditime të jashtme, shërbime të tjera siç përshkruhen më poshtë, dhe trajnime te ndryshme te organizuara në Shqipëri.

Partnerët tanë janë antarë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

ARMAND AVDOLLI

AUDITUES LIGJOR

Struktura ligjore

Armand Avdoli është person fizik i themeluar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 04.01.2008.

Organet drejtuese dhe manaxhimi

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë të fortë të përsosmërisë dhe etikës. Partnerët tanë vendosin përkushtimin e tyre në biznes dhe motivojnë stafin për të arritur standardet më të larta të sjelljes dhe performancës.

Entiteti administrohet nga Z. Armand Avdoli, auditues ligjor i regjistruar në Shqipëri.

Pjesë e shoqërisë për vitin 2020 është auditues ligjor i regjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Republikën e Shqipërisë:

- Armand Avdoli

Politikat e kontrollit të cilësisë

Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigoroze të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë.

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit. Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standardet e larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Shoqëria ka procedura të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

Manualet teknike dhe proceduriale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;

Trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të partnerëve dhe punonjësve nepermjet trajnimit të IEKA-s;

Vlerësim vjetor të stafit.

Shërbimet që Ofrojmë

Ne ofrojmë një portofol shërbimesh auditimi dhe konsulence për një bazë të diversifikuar klientësh. Shërbimet tona kryhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Ne mund t'ju asistojmë në auditim, kontabilitet, konsulencë, përgatitje, implementim, monitorim dhe vlerësim të organizatave, projekteve në:

- ✓ Auditim të pasqyrave financiare dhe kontroll ligjor të llogarive
- ✓ drejtim, pjesëmarrje dhe përgatitje të raporteve financiare mujore dhe vjetore në përputhje me SNRF-të dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,
- ✓ drejtim pjesëmarrje dhe mbështetje menaxhimi në punët e auditimit
- ✓ këshilla ligjore dhe taksash
- ✓ drejtim dhe pjesëmarrje të projekteve të punës së auditimit të brendshëm
- ✓ vlerësim të specializuara, analiza, plane biznesi, monitorim dhe vlerësim
- ✓ projektim dhe ofrim të trajnimeve të auditimit të brendshëm, shërbimeve financiare dhe auditimin menaxherial
- ✓ përkthim, interpretim dhe editim të punimeve të specializuara.

Cilësia e Auditimit

Ne jemi të përkushtuar ndaj cilësisë në shërbimet që ofrojmë. Për këtë ne jemi angazhuar përmes zhvillimit të politikave dhe procedurave të përfshira në manualët e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, kontrollit të cilësisë, pavarësisë dhe etikës.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit kryhet të paktën një herë në tre vjet. Procesi i Rishikimit të Cilësisë së Auditimit është hartuar për të monitoruar pajtueshmërinë e ekipit të angazhimit me standardet profesionale të auditimit dhe të etikës.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit kryhet nga partnerë të pavarur dhe të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. Përmes procesit të inspektimit shqyrtohen pasqyrat financiare, raportet e auditimit, letrat e punës dhe dosjet e angazhimit. Partneri i cili kryen Rishikimin e Cilësisë së Auditimit vlerëson nëse ekipi i angazhimit ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme dhe raportet e lëshuara nga firma anëtare janë të përshtatshme në rrethanat e caktuar. Këto përfshijnë përgjegjësitë e udhëheqjes për cilësinë, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, burimet njerëzore, ecurinë e angazhimit dhe monitorimin.

Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve të Konsulencës të Raportimit Financiar dhe Taksave

Shërbimet ne fushën e raportimit financiar dhe taksave konsiderohen si një çështje e rëndësishme për shumicën e shoqërive ndaj dhe ne i kushtojmë një vëmendje të veçantë ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë.

Mjedisi për planifikimin e taksave po bëhet gjithnjë e më tepër politik dhe i një profili të lartë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se ky mjedis dinamik nënkupton se klientët tanë kanë nevojë të vazhdueshme për konsulentë të besueshëm, të cilët mund të adresojnë të gjitha nevojat e tyre në lidhje me legjislacionin tatimor, raportimin financiar dhe planifikimin tatimor.

Në vitin 2020 ne u përqendruam në përmirësimin e aftësive dhe ekspertizës së punonjësve tanë përmes programeve të trajnimit dhe në përforcimin e procesit tonë të rishikimit me qëllim ofrimin e shërbimeve më profesionale.

Cilësia e Shërbimeve të Konsulencës dhe te tjera

Shërbimet tona të konsulencës ndihmojnë klientët të krijojnë, transformojnë dhe mbrojnë vlerat e tyre. Gjithashtu ne ndihmojmë klientët tanë të financojnë rritjen dhe optimizojnë operacionet e tyre, ne i këshillojmë ata se si të menaxhojnë riskun dhe mjedisin rregullator.

Informacione financiare

Ndarja e të ardhurave të audituesit Armand Avdoli për vitin 2020 është si në vijim:

Shërbimi	për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 <i>(të ardhurat në mijë lekë)</i>
Auditim ligjor	1,975
Angazhime te tjera	1,622
Totali	3,597

Shpërblimi i partnerëve

Partneri paguhen në bazë të pagës vjetore.

Njësi ekonomike me interes publik (NIP)

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat audituesi Armand Advolli ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (audituar gjate vitit 2020) është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 05.03.2009 ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", te ndryshuar

“Njësi ekonomike me interes publik” janë:

- ✓ të gjitha njësitet ekonomike të listuara në bursë;
- ✓ bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- ✓ shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- ✓ shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2020, Armand Avdoli kreu auditimin për entitet me interes publik për Pasqyrat Financiare të Vitit 2019 si më poshtë:

Shoqëria	Aktiviteti
Omnifactor shpk ALB-MS-97 sha	Institucion jobanka, licensuar nga BSH Ndertim, Tregeti.

Njësi ekonomike me interes publik (NIP)

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat audituesi Armand Avdoli ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (audituar gjatë vitit 2020) është dhënë në vijim për shoqëritë Omnifactor shpk dhe ALB-MS-97 sha. Te dy shoqëritë janë auditime në vazhdim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 05.03.2009 ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar

"Njësi ekonomike me interes publik" janë:

- të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- shoqëritë tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në bazë të VKM 17 dt.16.01.2019, shoqëria Omnifactor shpk është përcaktuar NIP për shkak të natyrës së biznesit (financiare jobanka), ndërsa shoqëria ALB-MS-97 shpk klasifikohet NIP për shkak të madhësisë së biznesit.